

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT
TË MBIKËQYRJES FINANCIARE PËR VITIN 2012

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

- Duke njohur e vlerësuar rolin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare në Republikën e Shqipërisë;
- Duke vlerësuar kontributin e tij në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së këtyre tregjeve;
- Duke vlerësuar rolin e këtij autoriteti për t'i siguruar Kuvendit, drejtuesve të institucioneve shtetërore dhe publikut, në përgjithësi, një informacion cilësor e profesional mbi këto tregje;
- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë Autoritet, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare.

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në drejtim të:

- Rritjes dhe konsolidimit të pozicionit të Autoritetit në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare;
- Përmirësimit të kuadrit ligjor ekzistues, duke reflektuar zhvillimet më të fundit të legjislacionit europian, ku përmenden miratimi i rregullores “Për kushtet e organizimit dhe funksionimit të platformës së tregtimit shumëpalësh” (MTF) dhe ndryshimi i rregullores për licencimin e bursës, që krijojnë mundësi për zhvillimin e tregut;
- Mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, duke garantuar në të njëjtën kohë edhe sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur;
- Projektimit, ndërtimit dhe administrimit të sistemeve informatike në mbështetje të strategjisë së Autoritetit për përmbushjen e nevojave të mbikëqyrjes së tregut, operatorëve të tij dhe mbrojtjen e konsumatorëve;
- Vendosjes dhe thellimit të bashkëpunimit me organizmat dhe institucionet, kombëtare dhe ndërkombëtare, në tërheqjen e politikave më të mira apo ofrimin e asistencës teknike të nevojshme;
- Menaxhimit në mënyrë të suksesshme të platformës GSRM, e cila siguron transparencë, në lidhje me kuotimet dhe transaksionet e tregut me pakicë të letrave me vlerë;
- Përfundimit me sukses të projekteve, si mbikëqyrja me fokus riskun dhe menaxhimi i sistemit të informacionit, të cilat janë shoqëruar edhe me një sërë përmirësimesh të teknologjisë së informacionit për të përmbushur objektivin tjetër, atë të mbështetjes së mbikëqyrjes me teknologji informacioni;
- Rritjes së transparencës në raport me konsumatorët, nëpërmjet përmirësimit të sistemeve elektronike dhe të informacionit *online*, ashtu edhe të metodave të tjera të informimit të publikut.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2013 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Plotësimin të mëtejshëm të kuadrit ligjor e në veçanti atij nënligjor në zbatim të akteve ligjore të miratuara deri tani, në përputhje me praktikën e vendeve të tjera dhe direktivat e Bashkimit Europian, për t'i dhënë njëkohësisht më tepër frymëmarrje nxitjes së planeve profesionale dhe unifikimit të praktikave plotësisht me ato europiane.
- Përgatitjes së kuadrit ligjor dhe marrjes së masave organizative, me synim përmirësimin e raportit dëme/prime;
- Nxitjen e fushatave edukuese për publikun, që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit për përfitimet nga produktet dhe shërbimet financiare në funksion të rritjes së efektivitetit dhe integritetit të tregjeve;
- Krijimit të hapësirave të nevojshme që lehtësojnë hyrjen e investitorëve dhe kapitalit të huaj në tregjet financiare jo bankare;
- Hartimit të një strategjie për zhvillimin e tregut të letrave me vlerë dhe, në veçanti, tregut të aksioneve, zbatimi i së cilës kërkon angazhimin dhe mbështetjen edhe të aktorëve të tjerë;
- Fokusimin në zbatimin e Planit Strategjik për mbikëqyrjen efektive, sistemin e paralajmërimit të hershëm për tregun e sigurimeve, si dhe transferimin e përvojës dhe njohurive të fituara deri më tani për

ndërtimin e kapaciteteve mbikëqyrëse, sipas metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus riskun në tregun e letrave me vlerë dhe të fondeve të pensioneve vullnetare private.

Miraturar në datën 25.3.2013

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)